

Numri i lëndës: 2024:091261

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05500981

**C.nr. 1077/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË V.**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Raif Fazliu, në çështjen juridike të paditësit H.T. nga T. komuna e V., kundër të paditurit S.S.nga S.S., duke vendosur sipas paditësit si propozues i sigurimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës gjyqësore më datë 25.03.2024 bie këtë:

### **A K T V E N D I M**

**I. CAKTOHET MASA E PËRKOHSHME E SIGURISË** e propozuar nga paditësi, si propozues i sigurimit H.T. nga T. e V., **I NDALOHET** kundërshtarit të sigurimit S.S.nga S.S., shitja apo tjetërsimi në çfarëdo mënyre qoftë, ngarkimi me hipotekë, apo çfarëdo ndryshimi faktik e juridik i ngastrës kadastrale nr. 188-0, me sipërfaqe prej 7164 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Smonica malo groblje” në zonën kadastrale në K., deri sa gjykata të bie vendim të ri e të plotëfuqishëm lidhur me këtë çështje.

**II.** Ky Aktvendim do t`ju dorëzohet, palëve ndërgjyqëse, zyrës për evidentimin e masave të sigurimit pranë Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në V., Zyrave noteriale në V. dhe Zyrës Kadastrale Komunale të Komunës së S.S.t.

Shpenzimet e deritashme të procedurës i bartë paditësi, si propozues i sigurimit.

### **A r s y e t i m**

Propozuesi i sigurimit H.T. nga T. e V., me padinë **C.nr.1077/2024**, datë 21.03.2024, ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme siguroese, përmes së cilës kishte propozuar t`i ndalohet kundërshtarit të sigurimit, S.S.nga S.S., shitja apo tjetërsimi në çfarëdo mënyre qoftë, ngarkimi me hipotekë, apo çfarëdo ndryshimi faktik e juridik i ngastrës kadastrale nr. 188-0, me sipërfaqe prej 7164 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Smonica malo groblje” në zonën kadastrale në K., deri sa gjykata të bie vendim të ri e të plotëfuqishëm lidhur me këtë çështje.

Propozimin e ka bërë duke ia bashkangjitur padisë bazën juridike për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të shitblerjes.

Propozuesi i sigurimit në propozim ka theksar se me të paditurin S.S.nga S.S. përmes kontratës private mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me datë 18.10.2023, e blerë ngastrën kontestuese nr.188-0, ZK K., e cila evidentohet në emër të babait të paditurit S.I.të cilën ngastër i ndjeri S.I.ia kishte falur tani shitësit S.S., përmes kontratës mbi faljen me datë 27.08.2021. Pasi ka blerë paditësi ka hy në posedim faktik, të cilin e mbanë edhe sot, duke shtuar se ndaj shitësit e ka përmbushur obligimin e kontraktuar.

Paditësi, tani propozuesi i sigurimit në lëndë ka deponuar provat si: certifikatën e pronës me nr. të lëndës 02/2024, e datës 09.01.2024, me ngastrën kontestuese nr.188-0, e cila është e regjistruara në emër të pronarit juridik S.I.Kontratën private mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e

lidhur dhe e hartuar me datë 18.10.2023, ndërmjet tani ndërgjyqësve dhe kontratën mbi dhuratën e lidhur me datë 27.08.2021, ndërsa e nënshkruar nga S.I.si faldhënës dhe S.S. si falmarrës.

Provat e lartëshënuara e bindin gjykatën se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës, apo të së drejtës subjektive të tij, nga fakti se provat e paraqitura e vërtetojnë se objekt shitblerje ishte tani ngastra kontestuese nr.188-0, me 7164 m<sup>2</sup>, ZK K., e cila iu ishte falur nga pronari juridik i saj tani shitësit, respektivisht të paditurit S.S..

Por për një pretendim të propozuesit të sigurimit se kundërshtari mund ta tjetërsoj ngastrën kontestuese leht është i qëndrueshëm, e kjo vërehet nga rastet analoge të cilat nuk janë të rralla. Andaj, në rast të mos caktimit të masës së përkohshme të sigurimit, si në dispozitiv të këtij aktvendimi, vërtetë paditësit do t'i vështirësohej realizimi i të drejtës subjektive.

Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet e parapara me nenet 297 dhe 300.1 shkronja a) të LPK-së, për t'u caktuar masa e përkohshme, pra propozuesi ka arritur ta bëjë të besueshme kërkesën e vetë.

Nga të cekurat më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 142. pika 5. lidhur me nenin 306 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË V.

C.nr.1077/2024

Më: 25.03.2024

Gj y q t a r i  
Raif Fazliu

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi ankesa nuk është e lejuar, konform nenit 310.5, të LPK-së, por kundërshtarit të sigurimit i lejohet kundërshtimi brenda afatit prej 3 ditësh konform nenit 306.2, të LPK-së.